

328
05.3.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 802/1 Prot

Elbasan më 5 /03/2025

VENDIM

Nr 21 datë 04 /03/2025.

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë për muajin JANAR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr 11 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondi i të ardhurave të bashkisë për muajin JANAR 2025, 78 familje me fond 211.600 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtor i Shërbimeve Sociale D.Shuli

Drejtori Juridik

A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar I Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala

Miratuar datë _____

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

862/2
06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 325/1 Prot

Elbasan më 6.3.2025

Lënda: Konfirmim akti


KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.21, datë 04.03.2025 “ Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i bashkisë për muajin Janar 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr. 863/1 Prot

Elbasan më 05 /03/ 2025

VENDIM

Nr. 22 datë 04 /03/2025

Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin JANAR 2025

Mbështetur në ligjin nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”, V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, si dhe bazuar në kriteret e VKB nr. 12 datë 23.02.2024 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”

VENDOSI

1. Të përfitojnë ndihmë ekonomike nga fondet e kushtëzuara për muajin JANAR 2025 gjithsej 246 familje me një fond prej 1.008.324 lekë.
2. Masa e pagesës për të gjitha familjet përfituese të jetë konform V.K.M nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike” paragrafi IV pika 11.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit Social dhe Drejtoria e Financës.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Drejtor i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetar I Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala

Miratuar datë _____

Pro _____

Kundër _____

Abstenim _____

86312

06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 326/11 Prot

Elbasan më 03.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.22, datë 04.03.2025 “Mbi dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për muajin Janar 2025”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 860/1 prot

Elbasan më 05.03 2025

VENDIM

Nr. 23 datë 04/03 2025

Mbi miratimin e kritereve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i Bashkise

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/02/2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar, bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 3 të kreut IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i Bashkisë si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit,
 2. Familje shumë të varfëra që për shkaqe sociale nuk arrijnë të aplikojnë sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
 3. Familje të varfëra me një bashkëshort të larguar (apo në burg) dhe që nuk mund të fillojnë procedurat e divorcit, apo nuk sigurojnë dokumentat përkatës.
 4. Familje me probleme të tjera sociale.
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë: Çertifikate familjare, fotokopje e kartës së identitetit, formulari i paraqitjes mujore, raporti (formulari) i përshkrimit të gjendjes social-ekonomike të familjes nga Administratori Shoqëror, dokument i statusit si punëkërkues i

papunë nga AKPA ,dokument pronësie si dhe dokumente të tjera plotësuese për dosjen e familjes që trajtohet me ndihmë ekonomike nga të ardhurat e Bashkisë.

- III. Masa e ndihmës ekonomike të llogaritet sipas VKM nr. 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtore i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtore Juridik A.Hoxha

Drejtore Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetar i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala



860/2

06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 367/1 Prot

Elbasan më 06. 3.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.23, datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i bashkisë”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 861/1 Prot

Elbasan më 05 /03/ 2025

VENDIM

Nr. 24 datë 04 /03/2025

**Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së Ndhmës Ekonomike nga fondi i kushtëzuar për
bllok-ndihmën ekonomike**

KËSHILLIT BASHKIAK

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ___/02/2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale , bazuar në ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, në nenin 21 të ligjit nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë” në pikën 1,2,3 të kreu IV të VKM nr. 597, datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”

VENDOSI

- I. Të miratojë kriteret për dhënien e ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën si më poshtë:
 1. Familje të varfëra të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 2. Familje me kryefamiljare femra në vështirësi ekonomike dhe sociale të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 3. Familje që kanë në përbërje anëtarë mbi moshë pune, por që nuk përfitojnë pension pleqërie të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
 4. Familje me shumë fëmijë të cilat nuk janë shpallur përfituese nga sistemi i pikëzimit .
- II. Dokumentat e aplikuesve të jenë të njëjta sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të



ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike “

- III. Masa e ndihmës ekonomike përlllogaritet nga Shërbimi Social Shtetëror sipas VKM nr 597 datë 04.09.2019 “Për përcaktimin e procedurave, dokumentacionit dhe masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmen ekonomike”
- IV. Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social dhe Komunitar si dhe Drejtoria e Financës.
- V. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtor i Shërbimeve Sociale D.Shuli
Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Finance-Buxhet

A. Merkja

Sekretari i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak
Lutfi Lala



761/2
06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 363/1 Prot

Elbasan më 6.3.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.24, datë 04.03.2025 “Mbi miratimin e kriterëve të dhënies së ndihmës ekonomike nga fondi i kushtëzuar për bllok-ndihmën ekonomike”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir BEJTJA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 889/1 prot

Elbasan me 05 03 2025

V E N D I M

Nr. 25 /datë 04 03 2025

Për vendosjen në institucionet rezidenciale të shërbimeve sociale.

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës / /2025 pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimit të Kujdesit Social e Komunitar, bazuar në ligjin nr.121/206 datë 24.11.2016 “Për Shërbimet e Kujdesit Shoqëror në R.Sh.”, neni 28 dhe VKM nr.518 datë 04.09.2018 “Për përcaktimin e kritereve dhe dokumentacionit të nevojshëm për pranimin e personave në institucionet rezidenciale publike dhe jopublike të përkujdesit shoqëror”,

V E N D O S I

Të miratojë vendosjen në Qendrën Sociale Balashe, në shërbimin rezidencial si më poshtë:

- I. E moshuara Znj. Fatmire Nasibi Musabelliu, e datëlindjes 15.01.1956, vendbanimi Elbasan, Lagje 28 Nentori, me nr. ID F65115195B.
- II. I moshuari Fatos Gjysho Avdiaj, i datelindjes 05.11.1958, vendbanimi Elbasan, Lagje Kongresi Elbasanit, Me nr ID F81105047M

Ngarkohen për zbatimin e këtij vendimi Drejtoria e Mbrojtjes dhe Përfshirjes sociale si dhe Drejtoria e Qendrës Sociale Balashe.

Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Drejtori i Përgjithshëm D. Rroseni

Drejtori Juridik A.Hoxha

Drejtori Buxhet-Finance

A.Merkja

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Kryetari i Këshillit Bashkiak

Lutfi Lala





REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1028/1 Prot.

Datë 05 . 03 . 2025

VENDIM

NR. 26 DATË 04 . 03 . 2025

MBI

“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2024”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .02.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi **“Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2024”**, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, neni 48, pika 1, udhëzimin e Ministrisë së Financave nr.22, date 30.07.2018 “Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të njësisve të vetëqeverisjes vendore”,

VENDOSI

1. Të miratojë “Raportin e monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë të vitit 2024 (janar-dhjetor)”, për Bashkinë Elbasan, sipas materialit bashkëngjitur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet administrata e Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes së tij.

SEKRETAR

KRYETAR
Lutfi Lala

P.Sekt.Buxhetit: M.Behluli
Dr.Buxhet Fin.: A.Merkja
D.P.Sh.M: S. Mehmeti
D.P.Zh.T.P.P: D.Meta
D.P.K.S.A.R.S: D.Rroseni
D.P.M.C.M.B.P: Sh. Çullhaj
Dr.Juridike: A.Hoxha
Zv/kryetar: A.Bylykbashi



1028/2

06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 369/1 Prot

Elbasan më 6.3.2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.26, datë 04.03.2025 “Raporti i monitorimit të buxhetit për 4-mujorin e tretë (janar-dhjetor) të vitit 2024”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Ilir BEJTJA



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 1134/1 Prot.

Datë 05 .03. 2025

VENDIM

NR. 27 DATË 04 . 03. 2025

MBI

“Korigjim (saktësim) i burimit të financimeve në buxhetin e vitit 2025”

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës ____ .03.2025, pasi mori në shqyrtim materialin e paraqitur nga Bashkia Elbasan mbi “Korigjim (saktësim) i burimit të financimeve në buxhetin e vitit 2025”, bazuar në ligjin nr.139/2015, datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, ligjin nr.9936, datë 26.06.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr.68/2017, datë 27.04.2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ”Udhëzimin plotësues nr.2, datë 24.01.2025 të Ministrisë së Financave “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2025” dhe vendimin e Këshillit Bashkiak nr.138, datë 26.12.2024, për “Miratimin e Buxhetit të Bashkisë Elbasan për vitin 2025, si dhe miratimin e Programit Buxhetor Afatmesëm 2025-2027”,

VENDOSI

1. Korigjimin e burimeve të financimit, në planin e të ardhurave për vitin 2025 (*Buxheti i vitit 2025, tab. nr.3 “Të ardhurat totale të Bashkisë Elbasan (Plani i arkës)”*), si më poshtë:

Shtohet : të ardhura të trashëguara nga viti 2024

86,000 mijë lekë,

Paksohet : plani i të ardhurave vendore për vitin 2025 (arkëtim debitorë)

49,000 mijë lekë taksë ndërtese

9,000 “ “ taksë trualli

1,000 “ “ tarife pastrimi

27,000 “ “ tarifë ndriçimi

86,000 mijë lekë

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria Buxhet Financë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes së tij.

SEKRETAR

P/Sekt..Buxhetit : M.Beluli
Dr.Buxhet Finance : A.Merkja
D.P.P.A.B.F: S. Mehmeti
Dr.Juridike: A. Hoxha

KRYETARI
Lutfi Lala



1134/2
11.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI FINANCIAR DHE SHËRBIMET MBËSHTETËSE

Nr. 370/1 Prot

Elbasan, më 11 . 3 .2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT TË BASHKISË ELBASAN

Në zbatim të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 "Për Prefektin e Qarkut", pasi u kontrollua ligjshmëria e aktit tuaj nr.27, datë 04.03.2025 "Korigjim (saktësim) i burimit të financimeve në buxhetin e vitit 2025", konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI
Ilir BEJTJA



371

05.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E INTEGRIMIT EUROPIAN PROJEKTEVE DHE DONATOREVE

Nr. 1096/1 prot

Elbasan me 05.03. 2025

KËSHILLIT BASHKIAK
ELBASAN

VENDIM

Nr. 28, datë 04/03/2025

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës / /2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari dhe administrata e Bashkisë, të rikonstruktimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Elbasan

VENDOSI:

1. Miratimin në parim të ristrukturimit të Këshillit Vendor të Sigurisë Publike Elbasan.
2. Ngarkohen për zbatim Kryetari i Bashkisë Elbasan sëbashku me strukturat përkatëse.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshill Bashkiak

Konceptoi: P.S.P. D.K.Kreka

Pranoi: D.I.E.P.D. E.Çuni

D.B.F.A. Merkja

D.D.J.A. Hoxha

Miratoi: Nënkryetare A.Bylykbashi

KRYETAR I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi LALA





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI I MONITORIMIT TE KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKIONEVE
TE DELEGUARA

Nr. 3711 Prot.

Elbasan më 10.3. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.28 datë 04.03.2025 “Për propozimin e rikonceptimit të Këshillit Vendor për sigurine publike”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

Ilir Bejtja





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN

DREJTORIA E PËRGJITHSHME E KUJDESIT SOCIAL ARSIMIT RINISË DHE
SPORTIT

Nr 1195/1 prot

Elbasan me 05.03. 2025

KËSHILLIT BASHKIAK

ELBASAN

VENDIM

Nr. 29, datë 04/03/2025

PËR

PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË PROJEKTIT QËNDRAVE
MULTIFUNKSIONALE DITORE PËR TË MOSHUARIT

Këshilli Bashkiak, në mbledhjen e tij të datës ___/___/2025, pasi shqyrtoi materialin e paraqitur nga Kryetari dhe administrata e Bashkisë, të Marrëveshjes: “Qendrave multifunksionale ditore për të moshuarit”

VENDOSI

1. Mbi miratimin në parim të marrëveshjes së projektit: “Qendrave multifunksionale ditore për të moshuarit”.
2. Ngarkohen për zbatim drejtoritë e Bashkisë Elbasan: Drejtoria e Përgjithshme e Kujdesit Social, Arsimit, Rinisë dhe Sportit, Agjencia e Shërbimeve Sociale dhe Drejtoria Juridike.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas miratimit në Këshillin Bashkiak.

Konceptoi: S.S.M.P.S
Pranoi: D.D.Sh.S
D.A.Sh.S
Miratroi: D.P.K.S.A.R.S
D.D.J

A.Çoku
E.Kolla
E.Palloshi
D.Roseni
A.Hoxha

Kryetar i Keshillit Bashkiak
Lutfi LALA





REPubLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN

SEKTORI I MONITORIMIT TE KOMPETENCAVE VENDORE DHE FUNKSIONEVE
TE DELEGUARA

Nr. 382/1 Prot.


Elbasan më 10 . 3 . 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.29 datë 04.03.2025 “Për miratimin e marrëveshjes së projektit të Qendrave Multifunkionale Ditore për të Moshuarit”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.





REPUBLIKA SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK ELBASAN

Nr 1219 Prot

Elbasan më, 05.03.2025

VENDIM

Nr. 30, datë 04.03.2025

Mbi emërimin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan

Këshilli Bashkiak në mbledhjen e tij të datës __.__.2025, nisur nga krijimi i vakancës së pozicionit të Sekretarit të Këshillit bashkiak, me propozim të Kryetarit të Këshillit, bazuar në Rregulloren e Këshillit Bashkiak Elbasan Neni 17, Ligjin Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Neni 57 dhe Neni 54 pika c:

VENDOSI:

1. Të miratojë emërimin e Z. Sokol Sinani në pozicionin e Sekretarit të Këshillit Bashkiak Elbasan.
2. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Këshilli Bashkiak Elbasan.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Konc.S.Gjorga 

KRYETARI I KËSHILLIT BASHKIAK

Lutfi Lala 



1219/1

06.03.2025



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI JURIDIK

Nr. 373/1 Prot.

Elbasan më 03. 2025

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK ELBASAN

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, i ndryshuar, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.30 datë 04.03.2025 “Mbi emërimin e sekretarit të Këshillit Bashkiak”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.



PREFEKTI

Hir BEJTJA